ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: ***KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.***

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: ***KEK-25-9287-1-2-1***

Sa i përket tenderit për: ***Furnizim me Natrium Hipoklorit***

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj:	*SEYKOS SH.P.K*
Adresa e plotë, vendi dhe kodi postar:	*Rr. Ali Vitia, ob-office 6.1, 10000 Prishtinë*
Numri Telefonit:	**049 135 760**
Numri i Faks-it:	**NA**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj:	**Shpejtim Kuçi**
Adresa elektronike:	*seykos_ks@yahoo.com*
Data e parashtrimit të kërkesës:	**07.01.2026**
Nënshkrimi dhe vula:	

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË. Shëno të dhënat si në vijim: NA

Emri i avokatit	
Adresa e plotë	
Numri i Telefonit	
Numri i faks-it	
Adresa elektronike	
Data e parashtrimit të ankesës	
Nënshkrimi dhe vula	

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

B05 – Njoftimi për kontratë; 13.10.2025
Dosja e Tenderit; 10.10.2025 14:02
Dorëzimi i Ofertave; 03.11.2025 12:00
Raporti i hapjes; 03.11.2025 12:10
Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues; 19.12.2025 13:45
Kërkesa për Rishqyrtim: 24.12.2025 15:50
Përgjigjja e kërkesës per rishqyrtim: 29.12.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒ X

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ X **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ X **Jo** ☐

Me të drejtë dhe konform LPP-ës, kemi paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK, kerkese kjo e nderlidhur me arsyet e eliminimit, nderkaq për te njejtën AK me datë 29.12.2025, ka publikuar përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim me të cilën ka refuzuar kërkesën si të pa bazuar!

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK, me rastin e publikimit të dokumentit Njoftimi mbi Vendimin e AK dt. 19.12.2025 dhe Letrën standarde për Tenderuesin e Eliminuar, ka vepruar në kundërshtim me LPP-së neni 6, 7, 59 dhe 72 si dhe Rregulloren për Prokurim Publik neni 38 paragrafi 38.7 dhe Neni 40 paragrafi 40.6 dhe 40.7.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

1 KRONOLOGJIA

1.1. Autoriteti Kontraktues, në këtë rast *KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a* , me datë 13.10.2025, ka iniciuar tenderin me titull: Furnizim me Natrium Hipoklorit, me ç'rast ne si OE te interesuar kemi marr pjese dhe kemi dorëzuar ofertën tonë të përgjegjshme brenda afateve kohore të parashikuara me Njoftimin për Kontrate. – **Provë: Njoftimi për Kontratë**

1.2. Autoriteti Kontraktues, me datë 19.12.2025, ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK dhe Letrën Standarde për Ofertuesin e Eliminuar, brenda së cilës ka njoftuar se kompania e jonë SEYKOS Shpk është e pa përgjegjshme për këtë aktivitet te prokurimit me arsyetimin, po citoj:

- ***"Mungon certifikata e kualitetit me parametra, kane ofruar me disa parametra qe është jashte përputhshmërisë me specifikacionin" mbyllet citati.***

Ndërsa përmes dokumentit 58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES ka njoftuar se si OE të suksesshëm ka propozuar OE Liridona Kaçiu B.I me vlere totale te ofertës 38,250.00 €. **– Provë: Njoftimi mbi vendimin AK dhe Letrën Standardë për Ofertuesin e Eliminua**r

1.3. Pas këtij vendimi, me te drejte dhe konform LPP-se, kemi kërkuar qasje në dokumentet e OE të shpërblyer me kontratë, dhe Operatorëve Ekonomik të tjerë pjesëmarrës në këtë aktivitet si dhe Raportin e Vlerësimit nga Komisioni vlerësues, dhe me pëlqim të AK ne kem pranuar edhe raportin e vlerësimit të ofertave për këtë tender, si dhe dokumentet e ofertave të OE pjesëmarrës, vetëm dokumentet qe nuk kan qen pjese e dokumenteve konfidenciale.

1.4. Me te drejte dhe brenda afateve te parapara me LPP, ne me dt. 24.12.2025 kemi paraqitur kërkesën për rishqyrtim pranë AK. – **Provë: Kërkesa për rishqyrtim;**

1.5. AK me datë 29.12.2025, e ka refuzuar kerkesen ton për rishqyrtim të vendimit si e pa bazuar. – **Provë: Vendimi i AK për Refuzimin e Kërkesës për rishqyrtim;**

2. Faktet dhe Argumentet që kundërshtojnë vendimin e AK për eliminimin e ofertës tonë

Të nderuar përfaqësues të OSHP-ës

Pas analizimit të plot të raportit të vlerësimit si dhe letrës B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar, ashtu si do të vërtetoni edhe ju gjatë shqyrtimit të kesaj ankese, zyra jone ligjore nuk ka gjetur as një fakt mbi të cilin AK e ka bazuar eliminimin e ofertës ton, dhe të gjitha arsyetimet e AK jane shume të përgjithësuar dhe pa fakte dhe pa baze ligjore.

Me poshtë ne do i shpjegojmë secilin dokument dhe përshkrimet qe ka përdorur AK ne keto dokumente si arsyetime për ta refuzuar ofertën tonë.

2.1. Ne raportin e vlerësimit faqe 7 dhe 9 të raportit AK si arsyetim për eliminim e ofertës tone cek, po citoj;

- **"OE Seykos SH.P.K. - është i papërgjegjshëm, mungon certifikata e kualitetit me parametra, kane ofruar me disa parametra qe është jashte përputhshmërisë me specifikacionin"** mbyllet citati.

2.2. E po ashtu edhe ne dokumentin B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar, si arsyetim për eliminim e ofertës tone cek, po citoj;

- **"Mungon certifikata e kualitetit me parametra, kane ofruar me disa parametra qe është jashte përputhshmërisë me specifikacionin"** mbyllet citati

Pra ne të dy dokument baze, të cekura ne piken 2.1 dhe 2.2, arsyetimi i AK për eliminimin e ofertës tone është shumë i përgjithësuar pa as një dëshmi apo fakt.

Së pari, pretendimi i AK ne të dy keto dokumente kur potencon se ofertës se OE SEYKOS shpk i " **mungon certifikata e kualitetit me parametra.**..",, është pretendim plotësisht i pa sakte, sepse nese i referoheni dokumenteve të ofertës tone, veçanërisht dokumentit me nr. 9 – Certifikata e Kualitetit e

Prodhuesit dhe dokumentit me nr. 16 Prodhuesi – Specifikat teknike, përdorimi dhe paketimi, ju mund te vërtetoni sakte se oferta jon kishte të bashkangjitur dy dokumente qe mbulojnë kërkesës në DT-se ne FDT neni 9.1&9.2 pika 3- Certifikate e kualitetit të produktit nga prodhuesi.

Së dyti, pretendimi i AK ne të dy keto dokumente kur potencon se OE SEYKOS shpk kan ofruar produkte " ... **kane ofruar me disa parametra qe është jashte përputhshmërisë me specifikacionin",** përveç që është pretendimi i përgjithësuar pa fakte, AK ne as njërin nga keto dokumente nuk ka dhen as një informate, se cilat pika, pjese apo specifika të produktit të ofruar nga OE SEYKOS shpk nuk përputhen me kërkesat e DT-se Aneksi-1.

Përderisa, nese i referoheni dokumenteve të ofertës tone, ju mund te vërtetoni sakte se oferta jon kishte të bashkangjitur dy dokumente qe mbulojnë kërkesës në DT-se ne FDT Aneksi 1 – Specifikat teknike të produktit, ku ishin të specifikuara qarte parametrat e produkteve të ofruar, veçanërisht dokumenti me nr. 9 – Certifikata e Kualitetit e Prodhuesit, ku ishin te detajuara parametrat e produktit tone, dhe ne dokumentin me nr. 16- Prodhuesi – Specifikat teknike, përdorimi dhe paketimi, ishte dokumenti ku prodhuesi kishte deklaruar zotimin mbi specifikimin teknik të AK, ku zotohej se nese OE SEYKOS shpk shpallet fitues, produktet e ofruara do të jen plotësisht sipas këtij specifikimi të kërkuar nga AK.

Pra nga fakti se AK i kishte ne dispozicion keto dokumente, dhe kishte marr ne vendim te tille, tregon se ky veprim bien ndesh se pari me DT, LPP nenin 7, neni 59, dhe 72 si dhe Rregulloren nr. 01/2022 plotësuar me rregulloren 02/2024 neni 38.

Ndërkaq, pas parashtrimit të kërkesës për rishqyrtim me dt. 24.12.2025, AK në vendimin e dt. 29.12.2025 për refuzimin e kërkesës tonë ka theksuar (sqarimi i AK):

ANALIZA DHE SQARIMI I KOMISIONIT TË VLERSIMIT

Sqarimi	- Lidhur me aktivitetin e prokurimit: " Furnizim me Natrium Hipoklorit " KEKO-25-278-121 komisioni i vlersimit ka shqyrtuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues OE SEYKOS SH.P.K - Prishtinë dhe refuzon me arsyen se: - Sa i përket pretendimit ankimor për çertifikatë të kualitetit është i pa bazuar, sepse në DT është kërkuar çertifikatë të kualitetit me të gjithë parametrat, ndërsa OE SEYKOS SH.P.K – Prishtinë ka ofruar çertifikatë të kualitetit në të cilën mungojnë parametrat si: - Pika e vlimit, 48-80 ◦C - Baker Cu, < 0.05ppm

Nese i referohemi DT, respektivisht FTD, Neni 9.1&9.2 - *Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale*, ju mund të vërtetoni se AK, ka kërkuar;

Kapaciteti teknik dhe profesional	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
1.Autenticitetit i produkteve dhe cilësisë reprezentuese *2.Çertifikate te produktit ne lidhje me përshtatjen dhe specifikat ose standardet*	*1. Autorizim nga prodhuesi i produktit ose dileri i autorizuar (nëse autorizimi është nga dileri atëherë si dëshmi te sillet kontratë ose autorizim mes dilerit dhe prodhuesit), për shitjen e produkteve qe ofroni.* *2. Certifikatë (Certifikimi I prodhuesit sipas ISO 9001-2015); ISO 14001-2015; ISO 45001-2015;* *3. Certifikate e kualitetit të produktit nga prodhuesi*

Prandaj, nese i referohemi kerkesave të DT, të cituar me lart, sidomos pikës 3. Ku kërkohet po citoj "*Certifikate e kualitetit të produktit nga prodhuesi",* ju vërtetoni se edhe vendimi i dt. 29.12.2025 i AK për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim, përvec qe është i padrejte dhe ne kundërshtim me dokumentet e ofertës tone dhe nenin 59 të LPP, ai bie ne kundërshtim me këtë kërkesën e DT-se, sepse AK ne vendimin e tij për refuzimin e kërkesës ton përdor arsyetimin, po citoj; "*sepse në DT është kërkuar certifikatë të kualitetit me të gjitha parametrat" mbyllet citati*, *ndërsa ne DT kërkohet po citoj "Certifikate e kualitetit të produktit nga prodhuesi"*.

Pra nga fakti se AK i kishte ne dispozicion dokumentet me numër 9 dhe 16 ne ofertën tonë, dhe kishte marr ne vendim të tillë me dt. 29.12.2025, tregon se ky veprim bien ndesh se pari me DT neni 9.1&9.2, LPP nenin 7, neni 59, dhe 72 si dhe Rregulloren nr. 01/2022 plotësuar me rregulloren 02/2024 neni 38, dhe veçanërisht me nenin 56 të LPP-së, paragrafi 3 respektivisht Rregulloren për prokurim publik nr. 01/2022 e plotësuar ne rregulloren nr. 02/2024, neni 40 paragrafi 40.12 ku thuhet po citoj "*Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkese apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit"* mbyllet citati.

Ndërsa sa i përket arsyetimit tjetër të AK qe ka cituar ne vendimin e dt. 29.12.2025 lidhur me mungesën e dëshmive për dy parametra ne certifikatën tonë, ky veprimin përvec qe është i padrejte, ai bien ndesh me LPP neni 59, 72 dhe neni 38 i Rregullores nr. 01/2022 plotësuar me rregulloren nr.02/2024. Sepse, nese AK ka pasur nevoje për keto sqarime, ateher ka qen i obliguar me ligj qe te na drejtohet me kërkesë për sqarime shtese lidhur me cdo paqartësi qe ka pasur rreth dokumenteve tona.

Të nderuara zyrtar të OSHP, një tjetër fakt qe tregon se vendimet e AK janë ne kundërshtim me LPP neni 1 dhe qëllimin e këtij aktiviteti, ju mund ta vërtetoni, nese i analizoni dokumentet e AK si "raportin e vlerësimit faqe 7 dhe 9", dokumentin "B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar" si dhe vendimin e AK dt. 29.12.2025 për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim, ku ju mund të vërtetoni se AK ka përdorur arsyetime të ndryshme për eliminim e ofertës tonë dhe refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

Pra ne rastin e eliminimit të ofertës tone përdorë si arsyetim po citoj **"Mungon certifikata e kualitetit me parametra, kane ofruar me disa parametra qe është jashte përputhshmërisë me specifikacionin",** ndërsa ne vendimin e dt. 29.12.205 si arsyetim për refuzimin e kërkesës tone përdor po citoj "**OE SEYKOS SH.P.K. – Prishtinë ka ofruar certifikatë të kualitetit në të cilën mungojnë parametrat".**

Prandaj, nese i analizojmë vetëm keto dy raste ju mund të vërtetoni paqëndrueshmërinë dhe dallimin mese vendimeve të AK, pra se pari na eliminon me arsyetim se ofertës tone i mungon dokumenti "Certifikata e kualitetit" ndërsa se dyti pas kërkesës tone për rishqyrtim, e pranon se ne paskemi ofruar certifikata të kualitetit, çka e mohon vendimin e vete për eliminim, mirëpo tani sipas AK certifikata e ofruar nga ne nuk i paska të specifikuar disa parametra të caktuar.

Prandaj, nese ju i referoheni dokumentit me nr. 9 – Certifikata e Kualitetit e Prodhuesit dhe dokumenti me nr. 16 Prodhuesi – Specifikat teknike, përdorimi dhe paketimi, ju mund te vërtetoni sakte se keto dokumente tregojnë shume qarte se produkti joni i ofruar është 100% sipas kerkesave të DT-se Aneksi 1, dhe se prodhuesi jone përvec certifikatës se kualitetit e garanton AK se mallrat e ofruara nga ne do te prodhohen dhe liferohen 100% sipas kerkesave të AK ne DT Aneksi-1.

Bazuar ne analizën e zyrës tone ligjore, AK me rastin e vlerësimit të ofertës ton si dhe vendimin e dt. 29.12.2025, se pari ka bere shkelje të LPP neni 6 sepse ka eliminuar ofertën me çmimin me të lire për këtë tender.

Pastaj shkelje të nenit 7 të LPP sepse nuk e ka trajtuar ne menyr te drejtë dhe të barabarte ofertën ton për këtë tender.

Po ashtu vendimi i AK bie ne kundërshtim edhe me LPP neni 28, neni 59 si dhe rregulloren e prokurimit neni 40, sepse nese i referoheni dokumenteve të ofertës ton, ju do të gjeni dokumentet me nr. 4, 5, 6, 6.1, 6.2, 6.3 7, 9 dhe 16 qe e plotësojnë kerkesen e AK të cekur ne DT-e pjesa e FDT-se neni 9.1&9.2 pika 1 dhe 2.

AK duke vepruar ne këtë mënyrë ka vepruar edhe ne kundërshtim me LPP neni 72 si dhe Rregulloren nen 38, sepse nese ka pasur dyshime apo nuk ka mundur të i deshifrojmë dokumentet e larte cekura është dashur të kërkoj sqarime nga OE si dhe nga prodhuesi për të sqaruar me detaje ofertën dhe kualitetin e produktit të ofruar, dhe secilin parametër apo specifike për të cilen AK ka pasur nevojë.

Pas vendimeve të AK ne kemi njoftuar edhe kompani prodhuese, e cila na ka sqaruar se;

- “Certifikata është e lëshuar konform standardit EN 901 2013 Tipi 1, dhe se të njëjtën certifikatë e japin për të gjitha bashkitë (komunat) Turke, shteteve evropiane, kompanisë pjesëmarrëse në Tenderë si dhe shumë kompanive globale duke përfshirë edhe Coca Cola.

Të nderuar përfaqësues të OSHP-ës, ndryshimi i certifikatave bie ndesh me procedurat dhe standardet ne këtë rast përfshin edhe tejkalim i autoritetit ku shprehimisht bie ndesh me protokollet ndërkombëtare të sigurisë së kemikateve.

PËRFUNDIM:

Ne si OE dhe përfaqësues të autorizuar si dhe diler i prodhuesit Koruma Klor Alkali San. ve Tic. A.Ş. jemi në dispozicion së bashku me prodhuesin të dëshmojmë për OSHP dhe AK se oferta e jonë dhe kemikatet e ofruara për këtë aktivitet janë në përputhje të plotë me kërkesat e AK dhe DT.

Andaj duke u bazuar në të gjitha të gjeturat e lartcekura kuptohet qartë se vlerësimi i ofertës tone nga Komisioni i Vlerësimit të AK dhe refuzimi i kërkesës tone për rishqyrtim nuk është ne përputhje me Dosjen e Tenderit, LPP dhe Rregulloren për Prokurim, prandaj **kërkojmë nga ju si Organ Shqyrtues që të APROVONI, si të bazuar ankesën tone, dhe të;**

ANULOHET, vendimi i AK-së Korporata Energjetike e Kosoves (KEK) sha i dt. 19.12.2025 për eliminimin e ofertës ton dhe lënda të kthehet në RIVLERËSIM dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni të plotë me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të Ligjit për Prokurim Publik, Rregullores nr. 01/2022 për Prokurim Publik dhe Udhëzimit nr. 01/2023 për Prokurim Publik.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëme materiale dhe ne reputacion.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura